



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Nr. _____prot.

Durrës, më __. __. 2021

Lënda : Formulari i Njoftimit të Fituesit

Për: OE. EMKO SHPK, Adresa: Tirane Vaqarr, Fshati Lalm, Pasuria Nr.102/26, Zona Kadastrale 2376.

Procedura e prokurimit: Proçedurë E Hapur mallra.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-87615-02-18-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Blerje pajisje për shkolla kopshte 20'832'000 lekë, sasia sipas preventivit, afati 60 ditë.

Publikime të mëparshme(*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike. [Nr. 26 datë 22 Shkurt 2021]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X, oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- | | |
|---|------------|
| 1. ERZENI/SH | J66902027T |
| Vlera 15.367.000 (pesëmbëdhjetë milion e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë) lekë | |
| 2. MURATI D | K42003004T |
| Vlera 15.458.625 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë) lekë | |
| 3. E M K O | K61424016V |
| Vlera 16.105.200 (gjashtëmbëdhjetë milion e njëqind e pesë mijë e dyqind) lekë | |
| 4. ERVIN LUZI | K71707007Q |
| Vlera 17.400.000 (shtatëmbëdhjetë milion e katërqind mijë) lekë | |
| 5. SHAGA | J96822229J |
| Vlera 18.657.870 (tetëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) lekë | |
| 6. "RO-AL" | J61811001M |
| Vlera 18.900.920 (tetëmbëdhjetë milion e nëntëqind mijë e nëntëqind e njëzet) lekë | |
| 7. BOLT | K91517011V |
| Vlera 19.535.100 (nëntëmbëdhjetë milion e pesëqind e tridhjetë e pesë mijë e njëqind) lekë | |
| 8. Selvije Abasllari | L64704601S |
| Vlera 19.679.250 (nëntëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë | |
| 8. MUCA | K01421002H |

Vlera 19.738.700 (nëntëmbëdhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind) lekë

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. ERZENI/SH	J66902027T
2. ERVIN LUZI	K71707007Q
3. "RO-AL"	J61811001M
4. Selvije Abasllari	L64704601S
5. MURATI D	K42003004T

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori Ekonomik ERZENI/SH me vlere te ofertes 15.367.000 lekë nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim të kërkuara në dokumentet e tenderit, konkretisht:

Ne shtojcen 9 të Dokumentave të Tenderit "KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT", Operatori Ekonomik nuk plotëson Kërkesën e Përgjithshme për Kualifikim lidhur me shlyerjen e detyrimeve tatimore, pasi bazuar ne vërtetimin Nr.351 Prot, Datë 25.02.2021 lëshuar nga organet e tatim taksave, rezulton se ka detyrime tatimore ne shumën 6.721.354 lekë për të cilat është lidhur marrëveshja me këste Nr.9398/2 Prot, Datë 03.12.2020.

Gjithashtu,nga vërtetimi i gjeneruar nga sistemi elektronik Nr.T03830161, Datë,02.04.2021 i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore rezulton se ka detyrime tatimore te papaguara.

Operatori Ekonomik nuk e përmbush kriterin e kerkuar pasi rezulton me detyrime.

Bashkangjitur vërtetimi Nr.351 Prot, Datë 25.02.2021,vertetimi elektronik Nr.T03830161, Datë,02.04.2021 dhe Marrëveshja Nr. 9398/2 Prot, Datë 03.02.2020. KVO vendos që ofertuesi **ERZENI/SH të mos kualifikohet.**

2. Operatori Ekonomik ERVIN LUZI me vlere te ofertes 17.400.000 lekë nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim të kërkuara në dokumentet e tenderit, konkretisht:

Nuk plotëson kërkesën 2.2.3 pika f) Furnizimet e mëparshme , të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 8.000.000 lekë, të realizuara gjatë 3 viteve te fundit, pasi vlera totale e punëve të ngjashme është më e vogël. KVO vendos që ofertuesi **ERVIN LUZI të mos kualifikohet.**

3. Operatori Ekonomik " RO-AL" me vlere te ofertes 18.900.920 lekë nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim të kërkuara në dokumentet e tenderit, konkretisht:

- Nuk plotëson kërkesën 2.2.2 pika a) Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2020, referuar ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, pasi nuk ka paraqitur dokument per të vërtetuar se nuk ka detyrime për vitin 2020 për Bashkinë Vorë ku ushtron aktivitetin. KVO vendos që ofertuesi "**RO-AL**" të mos kualifikohet.

4. Operatori Ekonomik "Selvije Abasllari" me vlere te ofertes 19.679.250 lekë nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim të kërkuara në dokumentet e tenderit, konkretisht:

-Nuk plotëson kërkesën 2.2.2 pika a) Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2020, referuar ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar

nga Administrata e Qeverisjes Vendore, pasi nuk ka paraqitur vertetimin per të vërtetuar se nuk ka detyrime për vitin 2020.

-Nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit 2.1 pasi shtojcat 2/1, 6, 7, 8 dhe 8/1 nuk janë të shprehura për objektin e prokurimit por janë për një objekt tjetër prokurimi.

KVO vendos që ofertuesi **“Selvije Abaslari” të mos kualifikohet.**

5. Për operatorin ekonomik **MURATI D** me vlerë të ofertës 15.458.625 lekë, Komisioni i Prokurimit Publik me Vendimin nr. 206/2021, datë 12.05.2021, Vendosi: 3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “MURATI D” Sh.P.K., duke e **skualifikuar** këtë operator ekonomik.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: OE. EMKO SHPK, Adresa: Tirane Vaqarr, Fshati Lalm, Pasuria Nr.102/26, Zona Kadastrale 2376, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej 16.105.200 (gjashtëmbëdhjetë milion e njëqind e pesë mijë e dyqind) lekë është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Durrës, Sheshi “Liria” Durrës, tel/fax 052222310, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) diteve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 09.04.2021.

Ankesa: ka ose jo __ Po __

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë 29.03.2021, 20.04.2021 dhe datë 12.05.2021 Vendimi i KPP-së nr.206/2021.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
ZËVËNDËSKRYETAR**

Emiriana Sako

Konceptoi: *A.Xhelilaj*

Pranoi: *A.Zhiti*

Miratoi: *A. Iljazaj*